

Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në Kosovë u rikuperua gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, nga rënia e shënuar në vitin 2020. Në TM1 2021, rritja reale e BPV-së sipas ASK-së ishte 5.6 përqind, ku rritja e konsumit dhe investimeve kontribuan pozitivisht, përderisa eksportet neto kontribuan negativisht. Mbështetur në indikator me frekuencë më të lartë të publikimit si eksporti i mallrave dhe shërbimeve, konsumi dhe investimet publike, remitencat, etj., rritja reale e BPV-së vlerësohet të ketë vazhduar edhe në TM2 2021.

Sistemi financiar shënoi rritje të aktivitetit gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, megjithëse ende në përballje me sfidat e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Të gjithë sektorët përbërës kontribuan në rritjen që në fund të marsit 2021 arriti vlerën prej 8.07 miliardë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm më të përshpejtuar, kryesisht ndikuar nga dinamikat pozitive në sektorin bankar dhe atë pensional,

Në baza tremujore, aktiviteti i sektorit bankar u mbështet kryesisht nga rritja e kreditimit, pasuar nga rritja e investimeve në letrat me vlerë dhe parasë së mbajtur në bankat komerciale. Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor. Me rritje u karakterizuan edhe kategoria e burimeve vetanake (nga fitimi i mbajtur dhe i realizuar). Megjithë rreziqet e rritura si pasojë e gjendjes pandemike, sektori bankar ka shfaqur aftësi të mira absorbuese kryesisht si rezultat i pozitës së favorshme në treguesit e shëndetit të tij, siç janë: pozita e mirë e kapitalizimit, likuiditetit, cilësia e lartë e portfolios kreditore si dhe profitabiliteti i qëndrueshëm.

Sektori pensional vijoi të karakterizohet me dinamika pozitive në asetet e përgjithshme edhe në TM1 2021. Përkundër masës së tërheqjes së 10 përqind të mjeteve nga kontribut-dhënësist, rritja e aseteve në këtë sektor kryesisht u mundësua nga rritja e kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe si dhe nga kthimi pozitiv nga investimet.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, me rritje u karakterizuan edhe asetet e sektorit të sigurimeve, sektor që shënoi edhe nivel më të lartë të primeve të arkëtuara. Megjithatë, niveli më i lartë i dëmeve të paguara (siguruesit dhe BKS-ja), ndikoi që sektori i sigurimeve të operonte me humbje në TM1 2021.

Përderisa ecuria më e ngadalshme e rritjes së aseteve të sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2020 kryesisht i'u atribuua revokimit të licencës së dy institucioneve mikrofinanciare si dhe efekteve të pandemisë COVID-19, në TM1 2021, ky sektor rikuperoi aktivitetin kreditor, shënoi performancë pozitive financiare dhe raportoi nivel të ulët të kredive jo-performuese.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 85.0 milionë euro, ku kërkesa për të investuar në fletë-obligacione qeveritare ishte për 2.18 herë më e lartë se sa kërkesa e Qeverisë së Kosovës.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	i
Zhvillimet Makroekonomike -----	4
Sistemi Financiar -----	5
Sektori Bankar-----	5
Asetet-----	6
Performanca e sektorit bankar-----	11
Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar -----	13
Sektori pensional-----	15
Sektori i sigurimeve-----	17
Performanca e sektorit të sigurimeve-----	18
Sektori mikrofinanciar-----	18
Asetet-----	18
Performanca e sektorit mikrofinanciar-----	20
Tregu i letrave me vlerë-----	21

GRAFIKËT DHE TABELAT

Grafik 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës-----	05
Grafik 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar-----	05
Grafik 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tremujorët përkatës-----	06
Grafik 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive-----	06
Grafik 5. Struktura e kredive sipas veprimtarie ekonomike-----	07
Grafik 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare-----	07
Grafik 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake-----	08
Grafik 8. Depozitat sipas burimeve-----	08
Grafik 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore-----	08
Grafik 9A. Depozitat e reja të arkëtuara-----	09
Grafik 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita-----	09
Grafik 11. Norma e interesit në kreditë ndaj korporatave-----	10
Grafik 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare-----	10
Grafik 13. Norma e interesit në depozita-----	10
Grafik 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare-----	10
Grafik 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare-----	11

Grafik 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	11
Grafik 17. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione -----	12
Grafik 18. Treguesit e solvencës -----	12
Grafik 19. Treguesit e likuiditetit -----	12
Grafik 20. Asetet e sektorit pensional -----	15
Grafik 21. Struktura e aseteve të FKPK-së -----	16
Grafik 22. Struktura e aseteve të FSKP-së -----	16
Grafik 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së -----	16
Grafik 24. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	17
Grafik 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	18
Grafik 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	18
Grafik 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare -----	19
Grafik 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë -----	19
Grafik 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	19
Grafik 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	20
Grafik 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	20
Grafik 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	21
Grafik 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	21
Grafik 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	21
Grafik 35. Shuma e borxhit të emetuar -----	21
Grafik 36. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	22
Grafik 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	22
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	24

Zhvillimet Makroekonomike¹

Bazuar në vlerësimet e ASK-së, BPV-ja reale në Kosovë gjatë TM1 2021 ka shënuar rritje të përshpejtuar prej 5.6 përqind. Konsumi dhe investimet rezultojnë të kenë kontribuar pozitivisht në rritje, ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik. Rritja e përshpejtuar e aktivitetit ekonomik vlerësohet se ka vazhduar edhe në TM2 2021. Këto vlerësime mbështeten në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, konsumit dhe investimeve publike, remitencave, etj.

Çmimet e konsumit shënuan rritje prej 0.6 përqind në TM1 2021, kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të mjeteve të komunikimit, pijeve alkoolike dhe duhanit, shërbimeve shëndetësore, arsimore, hoteliere, si dhe rritjes së ngadalësuar të çmimeve të ushqimit.


Zbutja e efekteve negative të pandemisë Covid-19 në zhvillimet ekonomike ka ndikuar në përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore krahasuar me tremujorët paraprak. Të hyrat buxhetore në TM1 2021 shënuan rritje prej 14.5 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rritje edhe më të lartë (30.5 përqind) duke bërë që buxheti i Kosovës të regjistroi deficit primar prej 32.6 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.5 miliardë euro që është për 28.3 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2020, ndërsa si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind nga 16.5 përqind.

Në sektorin e jashtëm deficieti i llogarisë rrjedhëse është më shumë se dyfishuar në TM1 2021, kryesisht për shkak të rritjes së deficitit të mallrave ndërsa bilanci pozitiv i shërbimeve dhe ai i të ardhurave dytësore kanë shënuar rritje. Deficiti tregtar i mallrave ishte 767.3 milionë euro apo 20.0 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2020, dinamikë që kryesisht i'u atribua rritjes së importit, përkundër rritjes së konsiderueshme të eksportit. Në kuadër të bilancit të pagesave, rritje të konsiderueshme në TM1 2021 kanë shënuar edhe remitencat (29.7 përqind) ndërsa IHD-të shënuan rritje prej 2.0 përqind.

¹ Për më shumë informata rreth zhvillimeve makroekonomike referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike (TM1 2021) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

Sistemi Financiar

Asetet e sistemit financiar në fund të marsit 2021 arritën vlerën në 8.07 miliardë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, sistemi financiar në vend u karakterizua me përshpejtim të ecurisë së rritjes, mbështetur kryesisht nga dinamikat pozitive në sektorin bankar dhe atë pensional, dhe në masë më të ulët sektorët tjerë (grafik 1).




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK.

Sektori bankar kishte kontributin kryesor në rritjen e aseteve të sistemit financiar në periudhën raportuese, asetet e të cilit shënuan rritje vjetore prej 15.4 përqind në mars 2021 (11.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar). Segment tjetër që shënoi përshpejtim të rritjes së aseteve prej 7.0 përqind nga 5.5 përqind në mars 2020 është edhe sektori pensional, megjithë tërheqjen e rreth 197.2 milionë euro deri në fund të marsit 2021 në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike (10% të mjeteve të trustit si masë në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike). Sektorët tjerë kishin kontribut pozitiv në rritjen e aseteve të sistemit, por në nivel më të ulët për shkak të peshës së ulët. Sektori i sigurimeve shënoi rritje të përshpejtuara të

aktivitetit përderisa ai mikrofinanciar ngadalësim të rritjes kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 160.0 milionë euro, kryesisht ndikuar nga aktiviteti i sektorit bankar (+96.0 milionë euro) dhe sektorit pensional (+56.1 milionë euro). Sektori i sigurimeve u rrit për 5.3 milionë euro, kurse ai mikrofinanciar për 0.5 milionë euro.

Grafik 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar




Rritja e theksuar e aseteve të sektorit bankar në këtë tremujor reflekton rritjen e depozitave, përderisa rritja e aktivitetit të sektorit pensional i'u atribua rritjes së kontributeve të arkëtuara dhe kthimit pozitiv nga investimet.

Sektori Bankar

Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, aktiviteti kredidhënës shënoi rritjen më të lartë, pasuar nga investimet në letrat me vlerë, dhe parasë së mbajtur në bankat komerciale. Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor. Me rritje u karakterizua edhe kategoria e burimeve vetanake (nga fitimi i mbajtur prej vitit të kaluar dhe atij të realizuar gjatë TM1 2021). Sa i përket

indikatoreve të shëndetit të sektorit, bankat vazhdojnë të jenë mirë të kapitalizuara, me nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe me cilësi të lartë të portfolios kreditore.

Grafik 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në trejmuorët përkatës



Asetet

Vlera e gjithsej aseteve të sektorit bankar në fund të TM1 2021 arriti në 5.45 miliardë euro, që përbën rritjen më të lartë të shënuar në njëmbëdhjetë vitet e fundit prej 15.4 përqind. Kjo rritje e theksuar e aktivitetit të sektorit reflekton kryesisht rritjen e nivelit të depozitave, veçanërisht atyre nga ekonomitë familjare. Kurse, në baza tremujore, asetet e sektorit bankar u rritën për 96.0 milionë euro gjatë TM1 2021. Aktiviteti kreditues i sektorit bankar (që zë peshën më të madhe në kuadër të aseteve të sektorit me pjesëmarrje prej 60.9 përqind) ka shënuar rritje për 74.2 milionë euro në këtë tremujor (grafik 3). Kategoria e bilancit me bankat komerciale, që janë kryesisht depozita dhe të ngjashme të investuara në bankat jashtë vendit, shënoi rritje për 62.4 milionë euro. Kategoria e investimeve në letrat me vlerë ka shënuar rritje për 72.5 milionë euro gjatë TM1 2021. Përderisa,


kategoria e parasë së mbajtur në trezor dhe në BQK u zvogëlua për 119.4 milionë euro në këtë tremujor, e që reflekton shpërndarjen e mjeteve në zërat investues të cilat kanë kthim më të lartë, siç janë kreditimi, letrat me vlerë dhe depozita në bankat jashtë vendit.

Kreditë

Vlera e gjithsej kredive aktive në fund të marsit 2021 arriti në 3.32 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.7 përqind (rritje prej 9.2 përqind në fund të marsit 2020). Kreditë ndaj korporatave jofinanciare, me pjesëmarrje 63.0 përqind në gjithsej kreditë, shënuan rritje më të ngadalësuar prej 7.3 përqind (8.4 përqind në fund të marsit 2020).

Ngjashëm, kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje më të ngadalësuar, prej 8.4 përqind nga 10.7 përqind sa ishte në mars të vitit 2020.

Grafik 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive




Në baza tremujore, kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje për 37.9 milionë euro gjatë TM1 2021 (21.7 milionë euro gjatë TM1 2020), përderisa kreditë ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 36.9 milionë euro (31.9 milionë euro gjatë TM1 2020) (grafik 4).

Në aspekt të veprimtarive ekonomike, në baza tremujore, sektorët me peshën më të madhe të

pjesëmarrjes në stokun e kredive aktive u karakterizuan me rritje.


Grafik 5. Ndryshimi tremujor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

Kreditimi ndaj sektorëve kyç të ekonomisë, siç janë ai i bujqësisë, prodhimtarisë, ndërtimtarisë dhe tregtisë u karakterizuan me rritje. Me rënie të kreditimit në këtë tremujor u karakterizua sektori i minierave dhe ai i energjetikës, por krahasuar me gjendjen në periudhën paraprake, kjo rënie ishte më pak e theksuar.

Grafik 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare në TM1



Burimi: BQK.

Kreditë e reja në TM1 2021 zbritën në vlerën prej 343.9 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 10.1 përqind krahasuar me TM1 2020. Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare u zvogëluan për 31.1 përqind dhe zbritën në vlerën prej 168.7 milionë euro në TM1


2020 (grafik 6). Rënie të theksuar shënuan kreditë për qëllime investuese, prej 53.6 përqind, vlera e të cilave zbriti në 85.6 milionë euro në këtë tremujor. Kurse, kreditë e reja për qëllime jinvestuese u karakterizuan me rritje vjetore prej 40.6 përqind, dhe arritën në vlerë prej 78.1 milionë euro në TM1 2021. Në aspekt sektorial, kreditë e reja ndaj sektorit të bujqësisë shënuan rritje, ndërsa sektorët tjerë u karakterizuan me rënie krahasuar me TM1 2020 (industriale, shërbyese, sektorëve tjerë).

Në anën tjetër, kreditë e reja ndaj ekonomive familjare shënuan rritje të theksuar. Vlera e gjithsej kredive të reja ishte për 37.7 milionë euro më e lartë kundrejt TM1 2020, duke arritur vlerën në 175.2 milionë euro gjatë TM1 2021. Prej tyre, kreditë e reja për qëllim konsumi shënuan rritjen prej 20.4 përqind, dhe arritën vlerën në 122.3 milionë në TM1 2021. Me rritje më të theksuar, prej 61.1 përqind, u karakterizuan kreditë e reja hipotekare që arritën vlerën në 42.9 milionë euro gjatë TM1 2021.

Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake përbëhet kryesisht prej depozitave (81.2 përqind), stoku i të cilave në fund të muajit mars 2021 arriti në 4.42 miliardë euro dhe shënoi një rritje vjetore prej 15.0 përqind (13.6 përqind në mars 2020). Po ashtu, edhe në baza tremujore, depozitat shënuan rritje të theksuar krahasuar me TM1 2020 (grafik 7). Kategoria e burimeve vetanake të sektorit u rrit për 31.8 milionë euro në TM1 2021 (për 21.8 milionë euro në TM1 2020), si rrjedhojë e fitimit të realizuar në këtë periudhë dhe fitimit të pashpërndarë. Në fund të muajit mars 2021, stoku i gjithsej ekuitetit arriti vlerën prej 641.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 18.5 përqind.

Grafik 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK.

Depozitat

Rritja dyshifrore prej 15.0 përqind e stokut të depozitave për të tretin vit me radhë, përkundër efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19, ndër tjerash mund të jetë rezultat i transferimit të 10 përqind të mjeteve të pensioneve në llogari të kontribut-dhënësve në fund të vitit të kaluar. Po ashtu, edhe rritja e theksuar e remitencave përgjatë vitit 2020 dhe fillimit të vitit 2021 mund të ketë ndikuar në rritje të depozitave prej ekonomive familjare.

Grafik 8. Depozitat sipas burimeve, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK.

Në fund të marsit 2021, stoku i gjithsej depozitave arriti vlerën prej 4.42 miliardë euro, rritje që kryesisht reflekton ecurinë e depozitave të arkëtuara prej

ekonomive familjare. Në baza tremujore, vetëm gjatë TM1 2021, depozitat u rritën për 62.2 milionë euro (zvogëlim prej 62.7 milionë euro në TM1 2020). Depozitat e arkëtuara nga ekonomitë familjare gjatë TM1 2021 u rritën për 93.2 milionë euro (+2.4 milionë euro në TM1 2020), ndërsa vlera e stokut në fund të periudhës arriti 3.03 miliardë euro. Në anën tjetër, depozitat e arkëtuara prej korporatave jofinanciare në këtë periudhë u zvogëluar për 35.4 milionë euro (-88.3 milionë euro në TM1 2020), ndërsa vlera e stokut në fund të periudhës arriti në 792.0 milionë euro.

Depozitat prej korporatave tjera financiare në këtë tremujor u zgjeruan për vetëm 6.5 milionë euro (+3.6 milionë euro në TM1 2020), e që kryesisht reflekton zhvillimet në sektorin pensional. Në fund të periudhës, stoku i kësaj kategorie shënoi vlerën prej 269.9 milionë euro.

Grafik 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK.

Sipas kategorive, depozitat e transferueshme u rritën në vlerë prej 25.3 milionë euro (-67.1 milionë euro në TM1 2020) në baza tremujore, kurse stoku i tyre arriti vlerën prej 2.81 miliardë euro në fund të periudhës (mars 2021) (grafik 9).

Në të njëjtën periudhë, depozitat e afatizuara u rritën për 8.9 milionë euro (+3.5 milionë euro gjatë TM1

2020), duke arritur vlerën prej 1.03 miliardë euro në fund të periudhës (mars 2021), përderisa depozitat e kursimeve u rritën për 28.0 milionë euro (+1.0 milionë euro gjatë TM1 2020), duke arritur vlerën prej 580.8 milionë euro në fund të periudhës (mars 2021).

Grafik 9-A. Depozitat e reja të arkëtuara, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.

Depozitat e transferueshme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej depozitat e sektorit (63.6 përqind), pasuar nga depozitat e afatizuara (23.3 përqind) dhe të kursimit (13.1 përqind).


Vlera e depozitave të reja të arkëtuara² në TM1 2021 ishte 103.2 milionë euro, prej të cilave 31.1 milionë euro ishin depozita të arkëtuara nga korporatat jofinanciare, ndërsa 72.1 milionë euro depozita të arkëtuara nga ekonomitë familjare (grafik 9A).

Normat e Interesit³

Norma mesatare e interesit në kredi në TM1 2021 qëndroi në 6.1 përqind, apo 0.2 pikë përqindje më e ulët kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita mbeti në nivel të përafërt me periudhën paraprake, në 1.5 përqind në TM4 2020. Rrjedhimisht, margjina në mes

të normës së interesit në kredi dhe asaj në depozita qëndroi në 4.7 pikë përqindje (grafik 10).

Grafik 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.

Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë për korporatat jofinanciare qëndroi në 6.1 përqind gjatë TM1 2021, ngjashëm me periudhën paraprake (grafik 11).

Në bazë të kategorive të kredive, norma e interesit për kreditë investive ishte më e lartë (6.3 përqind) krahasuar me normën e interesit për kreditë jo-investive (6.0 përqind). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ka rënie më të theksuar në normën e interesit për kreditë jo-investive (për 0.3 pikë përqindje) krahasuar me rënien për kreditë investive (për 0.1 pikë përqindje).


Në aspekt sektorial, norma e interesit në kreditë bujqësore shënoi rënie për 1.8 pikë përqindje, duke zbritur në mesataren prej 6.0 përqind.

Ngjashëm, edhe normat e interesit në kreditë industriale shënuan rënie, për 0.2 pikë përqindje, në 6.1 përqind.

² Depozita e reja përfshijnë depozitat e afatizuara

³ Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.


Grafik 11. Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.

Kurse, normat e interesit në kreditë për sektorin e shërbimeve dhe sektorëve tjerë shënuan rritje për 0.1 dhe 0.3 pikë përqindje, në 6.1 dhe 6.7 përqind, respektivisht.

Grafik 12. Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Tek ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 6.1 përqind, që paraqet një rënie për 0.5 pikë përqindje krahasuar me TM1 2020. Norma më e lartë e interesit ishte për kreditë konsumuese (6.4 përqind), e që shënoi rënie për 0.4 pikë përqindje krahasuar me TM1 2020. Për më shumë, edhe norma e interesit në kreditë hipotekare shënoi rënie gjatë këtij tremujori (prej 5.8 përqind në TM1 2020 në 5.3 përqind në TM1 2021) (grafik 12).

Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita qëndroi në nivel të përafërt me periudhën paraprake, në 1.5 përqind (grafik 13).

Grafik 13. Norma e interesit në depozita




Burimi: BQK.

Normat e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me ato për ekonomitë familjare, edhe pse dallimi mes tyre nuk është i lartë.

Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare qëndroi në 2.1 përqind (1.7 përqind në TM1 2020) (grafik 14).


Grafik 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare, sipas kategorive



Burimi: BQK.

Kurse, normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbetën të përafërta në këtë tremujor krahasuar me periudhën paraprake (TM1 2020). Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare qëndroi në 1.3 përqind, ngjashëm me normën për depozitat e afatizuara, kurse ato të kursimit në 0.3 përqind (grafik 15).

Grafik 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK.

Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar në TM1 2021 realizoi profit në vlerë prej 25.6 milionë euro, e që është për 3.9 milionë euro më i lartë krahasuar me TM1 2020 (grafik 16). Fitimi më i lartë i realizuar në TM4 2020 ishte kryesisht rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave (për 2.6 milionë euro) kundrejt rënies së shpenzimeve (për 1.3 milionë euro). Të hyrat gjatë këtij tremujori arritën vlerën në 73.3 milionë euro, ku të hyrat nga interesi (kryesisht të hyra nga interesi në kredi) zbritën në 50.2 milionë euro (rënie vjetore për 1.8 milionë euro). Në anën tjetër, të hyrat nga jo-interesi (kryesisht të hyra nga tarifatat dhe komisionet), shënuan rritje vjetore për 1.9 milionë euro krahasuar me TM1 2020 dhe arritën vlerën prej 18.1 milionë euro.

Shpenzimet e sektorit bankar shënuan vlerën prej 47.7 milionë euro në TM1 2021. Kategoria më e madhe, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, shënuan vlerën prej 27.5 milionë euro, e përafërt me TM1 2020. Kategoria e shpenzimeve të jo-interesit shënoi vlerën prej 11.8 milionë euro në TM1 2021 (për 1.7 milionë më e ulët se në periudhën paraprake), kryesisht si pasojë e ndarjes më të ulët të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme në kredi. Kurse, kategoria e shpenzimeve të interesit gjatë kësaj periudhe u zvogëlua për 0.3 milionë euro, duke qëndruar në 5.6 milionë euro në TM1 2021.

Grafik 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Rritja e të hyrave (3.7 përqind) kundrejt rënies së shpenzimeve (-2.7 përqind), ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të përmirësohet duke zbritur në nivelin prej 65.0 përqind në TM1 2021. Ky raport nënkupton që për çdo 1 euro të arkëtuar, sektori bankar shpenzon 0.650 euro (grafik 16).

Treguesit e shëndetit financiar

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhduan të jenë në nivel optimal edhe gjatë TM1 2021, duke tejkaluar minimumet e kërkuara me rregullore.


Grafik 17. Kredite joperformuese dhe mbulueshmeria me provizione



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK.

Kredite joperformuese, megjithëse u karakterizuan me tendencë rritjeje që nga TM1 2020, vazhdojnë të mbesin në nivel të ulët dhe të jenë mirë të mbuluara me provizione. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në mars 2021 qëndroi në nivel prej 2.7 përqind (2.5 përqind në fund të marsit 2020) (grafik 17). Kredite joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të provizionuara, në shkallë prej 140.5 përqind (133.0 përqind në fund të marsit 2020).

Grafik 18. Treguesi i solvencës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK.

Si rezultat i nivelit të kapitalit të trashëguar nga vitet paraprake dhe fitimit të realizuar në tremujorin e parë të vitit 2021, niveli i kapitalizimit të sektorit bankar qëndroi në nivele të kënaqshme. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivel prej 17.1

përqind në periudhë raportuese, nivel ky më i lartë për 0.6 pikë përqindje se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 18).

Rritja e këtij treguesi i atribuohet rritjes më të lartë të gjithsej kapitalit krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të mjeteve të peshuara me rrezik. Pra, rritja e kapitalit është ndikuar nga fitimi i realizuar deri në mars 2021 dhe fitimit të akumuluar nga periudhat paraprake. Kurse, rritja më e ngadalësuar e mjeteve të peshuara me rrezik reflekton ngadalësimin e rritjes së kreditimit krahasuar me periudhën paraprake.

Grafik 19. Treguesit e likuiditetit



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK.


Sa i përket likuiditetit të sektorit bankar, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra shënoi përmirësim të lehtë, për 2.9 pikë përqindje krahas gjendjes në fund të TM1 2020, duke qenëdruar në nivel prej 38.3 përqind. Rritja e këtij indikator kryesisht i'u atribua rritjes më të përsheptuar të mjeteve likuide (parasë së gatshme dhe ekuivalentët e saj, bilancit me bankat tjera, investimeve në letrat me vlerë) krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të detyrimeve afatshkurtra (kryesisht depozitave të transferueshme).

Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit

Bankar

Sektori bankar, para përhapjes së pandemisë Covid-19, ka operuar përgjithësisht në një ambient me nivel të ulët të rreziqeve. Përhapja e pandemisë Covid-19 në vitin 2020 si dhe masat e ndërmarra për mitigimin e pasojave të krizës ekonomike e sociale janë reflektuar në rritje të pasigurive të akterëve kryesor në ekonomi dhe për pasojë, rritje të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar. Mbështetur në tregues me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, është ndërtuar Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar, për matjen dhe vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.⁴ Indeksi është kalkuluar në baza tremujore për të vlerësuar nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut përmes këtij indeksi.

Grafik 1. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar




Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare, është shënuar ulje

të ndjeshmërisë ndaj rrezikut (lexo: rritje të indeksit) në TM1 2021 krahasuar me TM1 2020. Vlera e përgjithshme e indeksit në TM1 2021 është dukshëm mbi vlerën mesatare të indeksit (grafik 1), për dallim nga viti paraprak ku si pasojë e krizës pandemike, indeksi i përgjithshëm rezultoi të jetë nën vlerat mesatare historike në secilin tremujor.

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, rënie të indeksit (lexo: rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënoi indikatorin e rrezikut kreditor. Ndërsa, rritje të indeksit (ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënuan indikatorin e rrezikut të solvencës, likuiditetit, profitabilitetit, dhe tregut. Vlen të theksohet që indikatorin që matë rrezikun e tregut, ka peshë mjaftë të ulët në indeksin e përgjithshëm dhe lëvizjet në këtë indikator deri tani nuk paraqesin rrezik për sektorin bankar si rrjedhojë e nivelit të ulët të mjeteve të mbajtura në valutë të huaj (grafik 2).

Grafik 2. Kriteret përbërëse të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar




Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës në fund të TM1 2021 krahasuar me gjendjen në fund të TM1 2020 i atribuohet rritjes së kapitalizimit të sektorit. Në rritje të nivelit të kapitalizimit ka ndikuar rritja më e shpejtë e kapitalit rregullativ kundrejt rritjes më të ngadalësuar të aseteve që bartin rrezik.

⁴ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

Rritja e nivelit të kapitalit është rezultat i fitimit të pashpërndarë nga vitet e kaluara, si dhe fitimit të realizuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2021. Kurse, ngadalësimi i rritjes së asetëve që bartin rrezik është rezultat i ngadalësimit të rritjes së aktivitetit kreditues që nga fillimi i pandemisë krahasuar me trendin e viteve të fundit (rritje dyshifrore në tri vitet paraprake).

Grafik 3. Indikator i solvencës




Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit në TM1 2021 krahasuar me nivelin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të mjeteve likuide krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të detyrimeve afatshkurtra. Në kuadër të mjeteve likuide, kemi rritje të theksuar të parasë së mbajtur në BQK, bankat tjera komerciale dhe institucionet tjera financiare, si dhe investimeve në letrat me vlerë. Rritja e theksuar e mjeteve likuide reflekton ecurinë e gjithsej depozitave, të cilat u rritën konsiderueshëm krahasuar me muajin mars të vitit të kaluar.

Në anën tjetër, detyrimet afatshkurtra shënuan rritje më të ngadalësuar kundrejt mjeteve likuide, e që kryesisht janë depozita të cilat maturojnë brenda një vitit.

Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor kryesisht i'u atribuua rritjes së kredive joperformuese


në vlerë absolute si dhe në raport me gjithsej kreditë.

Grafik 4. Indikator i likuiditetit



Trendi rënës i vlerës së kredive joperformuese u ndërpre për herë të parë në TM1 2020, që nga TM4 2014 kur filloi rënie, dinamikë që ndër tjerash u ndikua prej ndryshimit metodologjik me fillimin e implementimit të standardeve të SNRF-9. Niveli i KJP-ve pritet të rritet edhe në periudhat në vijim, ngamë materjalizimin e dëmeve ekonomike e sociale që pandemia Covid-19 shkaktoi.


Grafik 5. Indikator i rrezikut kreditor



Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit i atribuohet zhvillimeve në të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar gjatë kësaj periudhe. Rritja e të hyrave të sektorit për 3.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishte rezultat i të hyrave nga jointerеси (tarifave dhe komisioneve); përderisa të hyrat prej interesit ishin më të ulëta për 1.6 përqind krahasuar me tremujorin e parë 2020.


Kurse, rënia e shpenzimeve për 2.7 përqind erdhi kryesisht si rezultat i rënies së shpenzimeve për provizionimin e humbjeve të mundshme në kredi. Si rrjedhojë, profiti më i lartë krahasuar me TM1 2020 ka ndikuar në përmirësim të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), si dhe në raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave.

Grafik 6. Indikator i profitabilitetit



Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut i'u atribuua uljes së pozicionit neto në valutë të huaj të sektorit bankar. Ky indikator ka peshën më të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar për shkak të nivelit të ulët të ekspozimeve si në asete dhe detyrime Për më tepër, edhe niveli i kredive dhe depozitave në valutë të huaj është në nivel mjaftë të ulët. Si rrjedhojë, lëvizjet në këtë indikator kanë ndikim mjaftë të ulët në indeksin e agreguar të stabilitetit financiar.

Grafik 7. Indikator i rrezikut të tregut




Sektori pensional

Aktiviteti i sektorit pensional gjatë TM1 2021 u zgjerua, kryesisht si rezultat i kthimit pozitiv në investime dhe kontributeve të arkëtuara nga kontribut-dhënësit.

Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 25.5 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar. Pavarësisht tërheqjes së mjeteve nga kontribut-dhënësit në nivel prej 10 përqind në fund të vitit 2020, gjithsej asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 7.0 përqind në mars 2021, duke arritur vlerën prej 2.06 miliardë euro. Kurse, në baza tremujore, vetëm gjatë TM1 2021, asetet e sektorit pensional u rritën për 56.1 milionë

euro (zvogëlim për 56.5 milionë euro në TM1 2020) (grafik 20).

Grafik 20. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK.

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

(FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP).


Grafik 21. Struktura e asetëve të FKPK-së (TM1 2021)



Burimi: FKPK.

Struktura e asetëve të FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, por që pesha e tyre gradualisht është zvogëluar kundrejt rritjes së peshës së mjeteve të investuara në vend. Rreth 71.2 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë vendit, apo rreth 1.46 miliardë euro të alokuara në fonde të përbashkëta investuese (grafik 21). Pjesa e mbetur e mjeteve u investuan brenda vendit, dhe arritën vlerë prej 590.2 milion euro në fund të marsit 2021. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë të investuara në fletë-obligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat vetëm gjatë TM1 2020 janë rritur për 10.5 milionë euro. Kategoria e mjeteve të deponuara në sektorin bankar është tkurrur për 9.1 milionë euro në këtë tremujor. Përderisa, paraja e mbajtur në Bankën Qendrore të Kosovës ka shënuar rënie më të theksuar, prej 47.5 milionë euro në TM1 2021. Zvogëlimi i parasë së gatshme (në BQK) dhe depozitave të mbajtura nëpër bankat komerciale reflekton edhe tërheqjen e 10 përqind të mjeteve të trustit nga kontribut-dhënësit në fund të vitit të kaluar.


Grafik 22. Struktura e asetëve të FSKP-së (TM1 2021)



Burimi: FSKP.

Edhe struktura e mjeteve të FSKP-së është e ngjashme me atë të FKPK-se, ku rreth 78.4 përqind e tyre janë të investuara jashtë vendit, dhe pjesa e mbetur në Kosovë. Portfolio e FSKP-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (63.4 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (20.7 përqind), paraja e gatshme (7.3 përqind) dhe instrumentet tjera (grafik 22). Gjithsej asetet e FSKP-së gjatë TM1 2021 u rritën për 264.7 mijë euro, prej të cilave pjesa më e madhe ishin investime në sektorin e brendshëm.

Grafik 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

Gjatë TM1 2021 FSKP-ja realizoi kthimi bruto në investime në vlerë prej 402.9 mijë euro (-910.0 mijë euro gjatë TM1 2020). Ndërsa, vlera e arkëtimeve të

reja nga kontribut-dhënësit gjatë TM1 2021 arriti në 124.3 mijë euro (130.0 mijë euro në TM1 2020).

Në këtë tremujor, kontributet e arkëtuara të FKPK-së u shtuan në vlerë prej 51.9 milionë euro, një rritje për 12.8 përqind krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. FKPK realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë prej 31.7 milionë euro gjatë TM1 2021, krahasuar me humbjet prej 90.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë, kur dhe kishte filluar të përhapet Covid-19, duke destabilizuar tregjet financiare dhe ekonominë globale.

Sektori i sigurimeve


Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit dhe nivel më të lartë të primeve të arkëtuara. Mirëpo, niveli më i lartë i dëmeve të paguara (siguruesit dhe BKS-ja), ndikoi që sektori të operonte me humbje në TM1 2021.

Asetet e sektorit të sigurimeve deri në fund të muajit mars 2021 arritën në vlerën 224.5 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 12.0 përqind. Depozitat e mbajtura në bankat komerciale dhe investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishin zërat me rritjen më të lartë. Kurse, vetëm gjatë TM1 2021, asetet e sektorit të sigurimeve u rritën për 5.3 milionë euro (grafik 24), rritje e mbështetur kryesisht nga depozitat e mbajtura në bankat komerciale, kategoria e risiguruesit për rezervat teknike si dhe huatë dhe të arkëtueshmet.

Në kuadër të kapitalit dhe detyrimeve, në këtë tremujor rritjen më të lartë shënuan rezervat teknike, kryesisht për dëmet e paguara. Kurse, rezervat për

primet u rritën në nivel më të ulët. Niveli i përgjithshëm i kapitalizimit të sektorit u karakterizua me rënie të lehtë. Vetëm gjatë këtij tremujori, gjithsej kapitali u zvogëlua për 0.1 milionë euro, kurse vlera në fund të marsit 2021 ishte 58.9 milionë euro. Gjithsej detyrimet e sektorit shënuan rritje gjatë kësaj periudhe për 5.4 milionë euro, dhe vlera e tyre në fund të marsit 2021 arriti në 165.7 milionë euro.

Grafik 24. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.

Vlera e primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve në TM1 2021 arriti në 25.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 12.6 përqind (2.1 përqind rritje vjetore gjatë TM1 2020) (grafik 25). Primet e kategorisë 'jo-jetë' përbëjnë 95.9 përqind të gjithsej primeve të shkruara, ndërsa ato të kategorisë 'jetë' 4.1 përqind.


Vlera e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë edhe Byronë Kosovare të Sigurimit) shënoi rritje gjatë TM1 2021 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Në TM1 2021, dëmeve të paguara arritën vlerën prej 15.6 milionë euro (13.9 milionë euro në TM1 2020) (grafik 25). Pasi që primet dhe dëmet gjatë kësaj periudhe u rritën njëtrajtshëm, raporti dëme/prime në TM1 2021 mbeti pothuajse i pandryshuar me periudhën paraprake, në 62.0 përqind (grafik 25).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Gjatë TM1 2021, sektori i sigurimeve performoi me humbje neto në vlerë prej 578.1 mijë euro (fitim neto në vlerë prej 1.7 milionë euro në TM1 2020)⁵.

Rezultatet negative financiare gjatë këtij tremujori reflektojnë kryesisht nivelin më të lart të dëmeve të ndodhura krahasuar me nivelin e arkëtimeve prej primeve të shkruara.

Grafik 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

Sektori mikrofinanciar


Gjatë TM1 2021 sektori ka shënuar rritje tremujore të kreditimit, performancë pozitive financiare, si dhe nivel të ulët të kredive jo-performuese.

Asetet

Sektori mikrofinanciar regjistroi rritje të ngadalësuar të aseteve prej 1.9 përqind (15.7 përqind rritje vjetore

në mars 2020), vlera e të cilave arriti në 315.9 milionë euro në fund të marsit 2021.

Grafik 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.

Kurse, në baza tremujore, asetet u rritën për 0.5 milionë euro gjatë TM1 2021 krahasuar me rritjen prej 0.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Aktiviteti kredidhënës i sektorit shënoi rritje pavarësisht masave kufizuese që ishin në fuqi për të luftuar pandeminë Covid-19. Për më tepër edhe aktiviteti i lizingjet u karakterizua me rritje gjatë kësaj periudhe (grafik 26).


Kreditë

Në baza vjetore, gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rënie për 3.1 përqind në fund të muajit mars 2021, përderisa stoku i tyre zbriti në 209.0 milionë euro. Rënia vjetore e kreditimit nga ky sektor ndikoi të dy kategoritë: korporatat jofinanciare dhe ekonomive familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rënie prej 3.4 përqind (9.6 përqind rritje vjetore deri në mars 2020), duke zvogëluar vlerën në 137.6 milionë euro në fund të marsit 2021. Kurse, vetëm gjatë TM1 2021, kreditë ndaj ekonomive

⁵ Fitim neto i është larguar fitim/humbja e kompanisë së sigurimit të cilës i është revokuar licence në vitin 2019


familjare u rritën për 3.5 milionë euro (grafik 27).

Grafik 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, ndryshimi vjetor i kredive



Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare në fund të marsit 2021 zbriti në vlerë prej 71.4 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.7 përqind (rritje vjetore prej 13.1 përqind deri në mars 2020). Në baza tremujore, gjatë TM1 2021, kreditë ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 1.2 milionë euro.

Grafik 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimi tremujor




Në aspekt sektorial, në baza tremujore, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë dhe shërbimeve tjera shënuan rritje. Kreditimi ndaj sektorit të tregtisë shënoi rënie, kurse kreditimi ndaj sektorit të ndërtimtarisë, industrisë dhe industrive tjera stagnoi në TM1 2021 (grafik 28).

Lizingjet

Në baza tremujore, edhe lizingjet kishin performancë të ngjashme me aktivitetin kredi-dhënës të sektorit mikrofinanciar gjatë TM1 2021. Aktiviteti i lizingut shënoi rritje në vlerë prej 0.3 milionë euro në TM1 2021 (1.5 milionë euro në TM1 2020), dhe arriti vlerën prej 57.6 milionë euro në fund të periudhës. Kjo rritje kryesisht reflekton lizingun ndaj korporatave jofinanciare, vlera e të cilit u shtua gjatë këtij tremujori për 0.4 milionë euro dhe arriti në 31.8 milionë euro në fund të periudhës (grafik 29).

Grafik 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Kurse, lizingu ndaj ekonomive familjare u zvogëluar për 0.1 milionë euro gjatë TM1 2021, përderisa vlera e përgjithshme e tyre në fund të marsit 2021 arriti në 25.8 milionë euro.

Normat e Interesit

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 20.1 përqind, apo për 0.6 pikë përqindje më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 30).


Grafik 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Tek ekonomitë familjare, norma e interesit shënoi rënie për 0.8 pikë përqindje, në 21.5 përqind gjatë TM1 2021 (grafik 30). Sipas kategorive të kredive, tek kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit u zvogëlua për 2.1 pikë përqindje në 19.9 përqind në TM1 2021. Kurse, tek kreditë konsumuese, kishte rritje për 0.8 pikë përqindje, në 22.9 përqind.

Grafik 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Po ashtu, edhe tek korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua, për 0.6 pikë përqindje, në 17.8 përqind. Në aspekt sektorial, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për sektorin e shërbimeve, pasuara nga kredit për sektorin e bujqësisë dhe industrisë. Norma mesatare tremujore e interesit për kreditë e bujqësisë


dhe industrisë shënoi rënie vjetore për 0.6 përkatësisht 0.4 pikë përqindje. Kurse, rritje marxhinale shënuan normat e interesit për kreditë ndaj sektorit të shërbimeve, të cilat historikisht kishin kushtet më të favorshme për të marrë kredi, në 15.5 përqind gjatë TM1 2021 (grafik 31).

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar përmbylli tremujorin e parë të vitit 2021 me fitim neto në vlerë prej 2.9 milionë euro. Kurse, gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar kishte operuar me humbje në vlerë prej 2.5 milionë euro. Kjo rritje e fitimit ishte kryesisht rezultat i rënies më të përshpejtuar të shpenzimeve kundrejt rënies së të hyrave. Të hyrat e sektorit gjatë këtij tremujori shënuan vlerën prej 11.2 milionë euro, që paraqet një rënie për 1.0 milionë euro krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia i'u atribua zvogëlimit të hyrave nga interesi për 1.1 milionë euro në 10.2 milionë euro gjatë TM1 2021 (grafik 32). Të hyrat nga jointerеси u rritën për 0.1 milionë euro gjatë këtij tremujori, duke arritur në 1.0 milionë euro, që kryesisht reflekton ecurinë e të hyrave nga shërbimet administrative.

Shpenzimet e sektorit shënuan vlerën prej 8.3 milionë euro gjatë TM1 2021, vlerë e cila është për 6.4 milionë euro më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton uljen e shpenzimeve nga jointerеси (provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë). Në të njëjtën periudhë, shpenzimet nga interesi dhe shpenzimet operative shënuan rënie më të ulët.


Grafik 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së sektorit, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim të dukshëm, duke u zvogëluar për 46.6 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake, duke qëndruar në nivel prej 73.8 përqind në TM1 2021. Kjo do të thotë që për çdo 1 euro të investuar, sektori mikrofinanciar ka shpenzuar rreth 0.738 euro.

Grafik 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




*Profiti është anualizuar për tremujorin përkatës
Burimi: BQK.

Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rritje të konsiderueshme në TM1 2021 (në 4.0 përqind dhe 17.3 përqind përkatësisht) krahasuar me ecurinë në TM1 2020 (grafik 33).

Sa i përket treguesve të cilësisë së portfolios kreditore të institucioneve mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe patën mbulueshmëri të mirë me provizione. Deri në fund të periudhës, kreditë jo-performuese ishin në nivel prej 3.0 përqind, përderisa mbulueshmëria e KJP-ve me provizione në fund të TM1 2021 ishte 145.8 përqind (grafik 34).

Grafik 34. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore




Burimi: BQK.

Tregu i letrave me vlerë

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, Qeveria e Kosovës emtoi borxh në vlerë dukshëm më të lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafik 35. Shuma e borxhit të emtuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave.

Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës në TM1 2020 shënoi rritje vjetore prej 54.5 përqind krahasuar me TM1 2020, duke arritur vlerën prej 85.0 milionë euro (grafik 35).

Kërkesa për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tejkalojë ofertën, që në TM1 2021 ishte për 2.18 herë më e lartë se sa shuma e kërkuar. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM1 2021 ishte 1.7 përqind, normë kjo më e lartë se në TM1 2021 për 0.5 pikë përqindje (grafik 36).

Grafik 36. Shuma e ofruar dhe emetuar




Burimi: Ministria e Financave.

Rritja e normës së interesit krahasuar me periudhën paraprake reflekton trendin e emetimit të letrave me vlerë drejtë maturimeve afatgjata.

Pra, struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitet prej 3 viteve, pasuar nga ato me maturitet prej 5 viteve.

Vlen të cekët që për të dytin vit me radhë, nuk kemi emetim të bonove të thesarit, maturiteti maksimal i të cilave është 364 ditë (grafik 37).

Grafik 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Sektori bankar, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë institucionet investuese në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, me ç'rast sektori pensional vazhdon të jetë më i ekspozuari.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2021): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 34, TM1 2021, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2021):

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK (2021):

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: [Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit \(IHÇK\), Qershor 2021 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit \(IÇP\), TM1 2021 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [Indeksi i Çmimeve të Importit \(IÇIMP\), TM1 2021 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: [Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë, TM1 2021 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: [Statistikat e Tregtisë së Jashtme \(STJ\), Maj 2021 | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)
- f) Buletini Tremujor: [Buletini Tremujor | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)

Të tjera (2021):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

Bloomberg (2021): Metal Prices database: [Commodities - Bloomberg](http://bloomberg.com)

FAO (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2021): Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2021): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Mars 2020	Mars 2021
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,410.0	1,493.0
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.1%	0.6%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.8%	1.2%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	397.3	454.9
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	373.7	487.5
Bilanci primar (në milionë euro)	23.5	-32.6
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,174.0	8,067.7
prej të cilave: Bankat	4,721.9	5,449.2
Kredi	3,083.3	3,320.8
Depozita	3,845.4	4,422.9
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.28%	6.12%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.32%	1.39%
Hendeku i normës së interesit	5.0%	4.7%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-72.5	-154.0
prej të cilave: remitencat e pranuar	187.3	242.9
Llogaria financiare	-103.5	-96.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	104.5	106.6
Investimet portfolio, net	-17.4	94.2
Investimet tjera, net	29.1	-3.8
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-592.2	-887.4
Asetet	5,054.3	5,348.4
Detyrimet	5,646.6	6,235.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,206.9	2,513.8
Borxhi i jashtëm privat	1,717.5	1,907.3
Borxhi i jashtëm publik	489.4	606.5

Burimi:

1/ ASK (2021);

2/ MF (2021);

3/ BQK (2021).

